



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PEJË
GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:248185
Datë: 19.04.2021
Numri i dokumentit: 01701443

P.nr. 969/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurve L. L. dhe D. L. nga të akuzuar për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore -Departamenti i përgjithshëm në Pejë, PP.nr.2314/19 të datës 24.10.2019, mbajti seancat publike të shqyrtimit gjyqësor me dt.02.03.2021 dhe 24.03.2021 në prezencë të Prokurori i shtetit, Muharrem Bajraktari, dhe të pandehurit L. L. dhe D. L. dhe e dëmtuara Ch. E. H., me dt. 24.03.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.19.04.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj te pandehurve

D. L. i lindur më në, ku edhe jeton Rr. nr.53 , i biri i S. L. dhe nënës P., e gjinisë M., ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, me nr. tel, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka qenë i ndaluar për këtë vepër sipas aktvendimit të prokurorisë RLN/II, nr.397/19 dt.11.10.2019, në afat prej 48 orëve, nga ora 18:40, i pa gjykuar më parë, mbrohet në liri.

L. L. i lindur më në, ku edhe jeton Rr., nr. 5 me numër, i biri i H. L. dhe nënës E. L., e gjinisë Zh., i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, përkthyes, i martuar, baba i 3 fëmijëve, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa gjykuar më parë, mbrohet në liri.

1.PJESA REFUZUESE

Ndaj të pandehurit L. L.

Konform nenit 363 par. 1 nen par. 1.1 te KPP-së,

REFUZOHET AKTAKUZA

Gjoja se

- Me date 11.10.2019, rreth orës 15:30 ne rr.”.....”, ne, pikërisht ne banesën e te pandehurit L., ne bashkëkryerje me te miturin E.K. e me qelli qe vetit ti sjellin dobi pasurore ne mënyrë te kundërligjshme, marrin pasurinë e luajtshme te dëmtuarës Ch. E. H., ne atë mënyrë qe te pandehurit shkojnë se bashku me te dëmtuarën Ch. E. H. dhe disa shok amerikan te organizatës jo qeveritare IMB dhe nga aty marrin : dy qante te vogla prej çantës se krahut te dëmtuarës ne te cilat ishin tre zarfe me para ne shume prej 1.500 euro, ku pasi e dëmtuara e vëren se i mungojnë çanta e lajmëron rastin ne polici e pas disa veprimeve hetimore policia çantat e te dëmtuarës se bashku me shumen e lartcekur i marrin nga te pandehurit dhe ja kthejnë te dëmtuarës,

-Me çka kishte për të kryer veprën penale, *vjedhje*, parashikuar nga neni 313 par. 1, lidhur me nenin 31 te KPRK-së.

-Për shkak të heqjes dorë të prokurorit nga ndjekja penale ndaj të pandehurit L. L. .

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

- E dëmtuara *Ch. E. H.* me vendbanim ne rr.”.....” nr. 24, nuk parashitroi kërkesë për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e njëjta u deklarua se heqë dorë nga nj kërkesë e tillë.

II. PJESA DËNUESE

I pandehuri D. L. ,

ËSHTË FAJTOR

PER SHKAK SE:

- Me date 11.10.2019, rreth orës 15:30 ne rr.”.....”, ne, pikërisht ne banesën e te pandehurit L., ne bashkëkryerje me te miturin E.K. e me qelli qe vetit ti sjellin dobi pasurore ne mënyrë te kundërligjshme, marrin pasurinë e luajtshme te dëmtuarës Ch. E. H., ne atë mënyrë qe te pandehurit shkojnë se bashku me te dëmtuarën Ch. E. H. dhe disa shok amerikan te organizatës jo qeveritare IMB dhe nga aty marrin : dy qante te vogla prej çantës se krahut te

dëmtuarës ne te cilat ishin tre zarfe me para ne shume prej 1.500 euro, ku pasi e dëmtuara e vëren se i mungojnë çanta e lajmëron rastin ne polici e pas disa veprimeve hetimore policia çantat e te dëmtuarës se bashku me shumen e lartcekur i marrin nga te pandehurit dhe ja kthejnë te dëmtuarës,

- Me çka ka kryer veprën penale, vjedhje nga neni 313 par. 1, te KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 39, 40, 43, 46,47,48, 49, 50,69,70, nenit 313 par. 1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPP-së të pandehurin e:

G J Y K O N

1. Me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilin dënim detyrohet që ta paguaj me se largu ne afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, dhe
2. Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, mirëpo ky dënim fare nuk do te ekzekutohen në rast se i pandehuri brenda periudhës 1 (një) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.
3. Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë te cekur si në pikën 1. në shumë prej 400 (katërqind) euro, nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur për një ditë qëndrimi në burgim nga 20 euro të gjobës.
4. I pandehuri detyrohet të paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale të krijuara shumen prej 40 (dyzetë) €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. I pandehuri po ashtu detyrohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
6. E dëmtuara **Ch. E. H.** me vendbanim ne rr.”.....” nr. 24, nuk parashtroi kërkes për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e njëjta u deklaruar se heqë dorë nga një kërkesë e tillë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II Nr.2314/19 të datës 24.10.2019, ndaj të pandehurve të pandehurve L. L. dhe D. L. nga të

akuzuar për shkak se ne bashkëkryerje kane kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 par 1 lidhur me nenin 31 te KPRK-së.

Konform nenit 305 të KPP-së me dt.24.03.2021 është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor në të cilën seancë, kanë qenë të pranishëm të gjitha palët e ftuara: Prokurori i shtetit, Muharrem Bajraktari, te pandehurit L. L. dhe D. L. dhe e dëmtuara **Ch. E. H.**

Para se gjykata të filloj seancën e shqyrtimit kryesor, fillimisht u siguru se e dëmtuara **Ch. E. H.** me shtetësi Amerikane a është në gjendje të përcjellë seancën në gjuhën e zyrtare shqipe, për çka e njëjta e konfirmoi se po dhe se nuk ka nevoja për përkthyes.

Gjykata konform dispozitave te nenit 323 par. 1 dhe 2, të KPP-së, i ka udhëzuar të pandehurit me të drejtat e tyre ku në këtë rast të pandehurit secili veç e veç u deklaruan se i kanë kuptuar këto të drejta dhe kanë shtuar se për mbrojtës nuk kanë nevojë.

Pas leximit të aktakuzës PP/II Nr.2314/19 të datës 24.10.2019,nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, përkatësisht veprën qe u vihen në ngarkesë sipas aktakuzës të pandehurve ju është dhënë mundësia qe të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke i njoftuar me kushtet, pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, krahas njoftimit se nëse e deklaroni fajësinë ju do të shpalleni fajtor dhe do të denohi në kuadër të sanksionit të parapar për vepër penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK-ës, për të cilën ligjvënësi ka parapar ndëshkushmerin dënim me gjobë dhe me burgim deri në tri vjetë. Nuk do të ketë nevojë të dëgjohen dëshmitaret, ekspertet dhe palët e popozuara për degjime, por do të vazhdohet me fjalën përfundimtare dhe vazhdimin për nxjerrjen e vendimit mbi dënim.

Pas këti njoftimi të pandehurit të ftuar nga gjykata për deklarim apo mos deklarim fajësie deklaruan vijueshëm:

I pandehuri **D. L.** e pranon fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, ndihet i penduar, premtion se ne te ardhmen nuk do te përsëris vepra te tilla penale, dhe deklaroi se L. nuk ka marr pjese ne vjedhje, vetëm ai dhe Erisi.

I pandehuri **L. L.** deklaroi se nuk e pranon fajësinë, nuk e ndien veten fajtor, nuk ka lidhje me këtë çështje.

Prokurori i shtetit pas deklamimit të pandehurve për gjykatën deklaroi se: pajtohet me pranimin e fajësisë që bëri këtu i pandehuri D. L. , ku me sa kuptova është pranim i vullnetshëm, i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, e po ashtu ky pranim ka mbështetje në shkresat e lëndës. I kërkoj gjykates qe pranimin e fajësisë ta aprovoj dhe ta marrë si rrethanë lehtësuese me rastin shqiptimit të dënimit.

E dëmtuara, **Ch. E. H.** e ftuar për tu deklaruar në lidhje me fajësinë e D. L. qe e deklaroi për veprën në dëme të saj, ka deklaruar se po ashtu pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e D. L.

, nuk kërkon kompensim demi, ja ka fal, E. ia ka marr 300 euro, ato ja ka dhënë gjyshes vet dhe me nuk ia kanë kthye, D. L. e ka përmbush detyrimin ndaj saj, për E. është zhvilluar procedura për të mitur, e ka kryer procedurën, i kanë mbetur borxh edhe 300 euro, e rithekson se D. L. e ka përmbush detyrimin.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit D. L. me aktvendim në procesverbal dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hedhje të aktakuzës dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave sa i përket të pandehurit D. L. , përderisa për të pandehurin L. L. ka vazhduar procedura e të provuarit pasi që i njëjti u deklaroi i pafajshëm ku pas fjalës hyrëse të palëve, dëgjimit të dëmtuarës **C. E. H.**, me administrimin e provave formale dhe materiale dhe me dëgjimin e mbrojtjes së të pandehurit L. L. dhe se fundmi me fjalën përfundimtare të gjitha palëve, gjykata e veçmas pa anashkalu por gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve dhe me shqiptimin e dënimit.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e bën përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës ku në rreshtin e tete të dispozitivit hiqet shuma 1700 euro dhe në vend të saj vendoset shuma 1500 euro. E ky ndryshim behet duke u bazuar në deklarinë e sotëm të dëmtuarës Ch.. Pjesa tjetër e dispozitivit mbetet e pandryshuar. E nderuar gjykatë, kemi ngritur aktakuzë për dy të pandehur ku i pandehuri i parë D. L. me vullnetin e lire dhe bindjen e tij të brendshme e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barre. Pra me vet pranimin e fajësisë, pranim që e ka mbështetur edhe në shkresat e lëndës u vërtetua që i njëjti e ka kryer veprën penale që i vihet në barre, kështu që kërkon nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ti jap dënimin e merituar.

Sa i përket të pandehurit L. L. , pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe përgjigjeve që i beri këtu e dëmtuara, e duke përfshirë edhe deklaratën personale të deponuar si prove, konsideron që nuk ka prova konkrete se i njëjti e ka kryer veprën penale që i vihet në barre prandaj në mungesë të provave tërhiqet nga ndjekja penale për të akuzuarin L. L. nësi në aktakuzën PP.II.2314/19 e dt. 24/10/2019. Këtë tërheqjeje e bën sepse nga vet përshkrimi i ngjarjes si ditën kritike e edhe në periudhë me të gjatë kohore të dëmtuarit e përshkruan si person familjar të tyre ku kanë bashkëpunime në shumë fusha të jetës e po ashtu e dëmtuara me familjen e saj dhe organizatën që e udhëheqë të njëjtin e kanë ndihmuar në përballimin e shpenzimeve të shërimit. Po ashtu i njëjti nuk evidentohet në shënimet e tyre si kryes i ndonjë veprë të re penale. Meqenëse i pandehuri L. ishte në ditët pas operimit dhe vazhdohej të përkrahej me mjete materiale nga njerëz të ndryshme konsideron që edhe shuma e pranuar nga 50 euro nga i pandehuri D. e ka pranuar duke qenë i bindur se është shumë nga humaniteti e ato para kanë qenë para të fituara me mirëbesim. Prandaj këto janë arsyet se pse ndaj të njëjtit u tërhoq apo nuk bën ndonjë rikualifikim të veprës penale ndaj të pandehurit.

E dëmtuara në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: i bashkëngjitet fjalës së prokurorit të shtetit. L. është i pafajshëm. Nuk kërkon dëmshpërblim as asnjë kompensim nga D., sa i përket ndjekjes penale ia le organeve të drejtësisë.

I pandehuri D. L. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e ndien veten fajtor, i vie keq që ka ndodhur, edhe iu kërkon shume falje edhe të dëmtuarve Ch. dhe S., dhe L. i cili është maltrëtuar në procedurë penale, dhe këso vepra nuk do ndodhin me ne të ardhmen, i premtonte gjykatës që me nuk do përsëris vepra të tilla. Kërkon nga gjykata, pasi që është hera e parë për këso veprë penale të ia lehtësojë me një dënim sa me të lehtë.

Gjykata në raport me të pandehurin L. L. e mbështetur në fjalën përfundimtare të prokuroit të shtetit, e cila fjalë përfundimtare rezultoi me heqjen dorë nga ndjekja penale ndaj të pandehurit se ka kryer vepra penale të bashkryerjes së vjedhjes nga neni 313 par.1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-ës me të pandehurin D. L. e që ky i fundit vullnetshëm pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit e deklaroi fajësinë, e që sipas pakurorit heqja dorë për të pandehurin L., rezultat pas administrimit të provave gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata në kuptim të nenit 363 par. 1 nen par. 1.1 të KPP-së, ndaj të pandehurit L. L. , gjykata sjelli aktgjykim Refuzues gjeja se ka kryer vepër penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-ës (Për më shumë shihe PJESEN E I-rë të dispozitivit), përderisa për të pandehurin D. L. i cili e pranoi fajësinë në kuptim të nenit 326 pa.1 të KPPRK-ës, që në fillim të shqyrtimit gjyqësor pas leximit të akuzës, ndaj të njëjtit pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor është marrë Aktgjykim fajësues në kuptim të nenit 365 par.1 të KPPRK-ës, për vepër penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK-ës(Për më shumë si në PJESEN E II-të, të diapozitivit tani i përpiluar pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor e duke u përkujdesur sipas detyrës si gjykata në kuptim të nenit 361 në kualifikimin juridik me heqjen e bashkryerjes të nenit 31 në raport me raport me të pandehurin L. L.), e që për këtë të fundit gjykata vazhdon së elabouari më tutje aktgjykimin pikat arsytuse që i referohen pranimit të fajësisë nga ana e tijë, provave mbështetëse të pranimit të fajësisë, ekzistencës së veprës penale, veprimeve të pandehurit, përgjegjshmerisë së tijë dhe aplikimit të rrethanave në drejtim të gjetjes meritore të aplikimit të dënimit meritore për veprën penale të kryer nga ana e tij.

Gjykata, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, dhe pranimi i fajit mbështetet edhe në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2019-DA-2042 të dt. 11.10.2019, raporti i policit H. S. dt. 11.10.2019, deklarata e të dëmtuarës Ch. E. H. e dhënë në polici me dt. 11.10.2019, deklarata e të pandehurit D. L. e dhënë në polici me dt. 12.10.2019, deklarata e të pandehurit E.K. – i mitur e dhënë në polici me dt. 11.10.2019, deklarata e të pandehurit L. L. e dhënë në polici me dt. 12.10.2019, aktvendim për ndalimin e personit të arrestuar, dëftese mbi konfiskimin e pronës dt. 11.10.2019, fotografi, vërtetimin mbi kthimin e sendeve, si dhe shkresat tjera të lëndes, si dhe shkresat tjera të lëndes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në tani me dispozitiv të aktgjykimit në raport me pjesën e II, të aktgjykimit, e pas përmirësimit të

vlerës së shumës gabimisht 1700 euro, e tani më përmirësim në shumën 1500 euro, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit D. L. , qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale se ka kryer veprë penale vjedhje nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurve, gjykata mori pranimin e fajësisë, sinqeritetin deklarues, pendimin për veprën e kryer, si dhe faktin se i pandehuri me parë nuk kanë qenë i dënuar dhe nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, të dëmtuarës i janë kthyer të hollat, e dëmtuara nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 453 par. 1 të KPPRK-se, gjykata për të pandehurin D. L. ka përcaktuar shpenzimet procedurale, në shumë prej 40 (dyzetë) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj, duke e detyruar që tja pagun gjykatës në afat prej 15(pesmbëshjet) ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, gjykata e detyroi të pandehurin D. L. që gjykatës tja pagunë taksën në shumë prej 30(tridhjet euro), në afat prej 15(pesmbëshjet) ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore sa i përket të pandehurit L. L. konform nenit 454 par.1 të KPPK-së, pasi që prokurori heqi dorë nga aktakuza

Vendimin për mosë udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civilo-juridik, gjykata e mori në përputhje me nenin 461 par.1, të KPPRK-ës, pasi që e dëmtuara në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor u deklarua se janë kompensuar dhe nuk parashtron kurrfarë kërkesë në raport me të pandehurit.

Meqenëse prokurori i shtetit hoqi dorë nga aktakuza PP/II.nr.2314/19, e dt. 24.10.2019 nga ndjekja penale ndaj të pandehurit L. L. për veprën penale vjedhje nga neni 313 par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, u vendos si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 363 të KPP-së dhe nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.969/19 dt. 19.04.2021**

Bashkëpunëtore profesionale

Selvane Bukleta

GJYQTARI

Dr. Sc. Murat Hulaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:248185
Datë: 19.04.2021
Numri i dokumentit: 01701443